

VENDIM
Nr.1156, datë 13.8.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS PERONDI, TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Perondi, të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Perondi, të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.704, datë 19.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Perondi, të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Perondi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Perondi

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
21-23	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
1-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
62-70	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
71-92	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
29-60	Varrezat publike	Në pronësi
93-113,142,144,145,153,159-163 (Vetëm troje të lira), 165	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
26-28	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
376-448,492-882,887-903,908-1285	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime	Në pronësi

	publike)	
331	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
93-113,142,144,145,153,159-163 (Vetëm trojet e zëna), 114-141,143,146-152,154-158, 164	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
1286-1288,1291-1294,1296-1299,1301,1303-1305	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
1289,1290,1295,1300,1302,1306,1473-1529	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi